



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.276/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Faranciska Zhitija –Ymeri ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “E...” Sh.p.k, me adresë rr. “...” nr.86 Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, i përfaqësuar nga V.K. L.L.M, ndaj debitorit N.T.P “F...” përfaqësuar nga K.B., me adresë rr. “...” në Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.566/20 të datës 29.01.2021, me datën 21.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit N.T.P “F...” përfaqësuar nga K.B., me adresë rr. “...” në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.566/20 të datës 29.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.566/20 të datës 29.01.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P “F...” përfaqësuar nga K.B., me adresë rr.”...” në Mitrovicë, i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.475/20, të datës 17.08.2020, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferri për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave ligjore, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkalles së parë ta prish dhe lëndën ta kthej në rivendosje.

Përgjigje ndaj ankesës së debitorit ka ushtruar kreditori, me pretendimin se e kundërshton si të pabazuar ankesën e debitorit, e parashtuar me qellim të prolongimit të procedurës përmbarimore, shton se të gjitha faturat janë nënshkruar nga debitori dhe i njëjti është dashur ti

përgjigjet detyrimin ndaj kreditorit, propozon që gjykata ta refuzoj si të pabazuar ankesën e debitorit dhe ta vërtetoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbirim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave me nr.IL dt.21.01.2020, IL ...dt.13.06.2019, IL ...dt.23.07.2019, IL ... dt.09.04.2019, IL ... dt.12.05.2020, IL ... dt.21.01.2020, IL ... dt.12.12.2019, IL ...dt.29.08.2019, IL ...dt.18.04.2019. Përmbiruesi privat Isa Gacaferri nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbirimor P.nr.475/2020 të datës 17.08.2020, ka lejuar përmbirimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën në total prej 8,046.29 euro, shumë kjo e precizuar në përgjigjen e kreditorit të datës 06.01.2021 ndaj konkluzionit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.556/2020.

Kundër urdhrin përmbirimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 31.08.2020, duke theksuar se me kreditorin nuk kemi asnjë marrëveshje për furnizim për vitin 2020 dhe se nuk kemi proces barazim deri në momentin e inicimit të propozimit për përmbirim, ky propozim është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Po ashtu deklaroi se me rastin e arritjes së marrëveshjes kreditori dhe debitori janë pajuar duke u mbështetur në rregullat e moralit afarist-dokeve të mira afariste që në çdo fund vit të ardhëm kalendarik të bëjë procesin e barazimit në koordinim të përbashkët, për konfirmimin e saldove financiare. Faturat në rastin konkret nuk janë të përshtatshme për përmbirim sepse koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare. Thotë se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 32 par.1 të LPP e lidhur me par.3 të njëjtit nen sepse kreditori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij që ka qenë barazimi i saldove financiare dhe ekzistimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për vitin 2020, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta prish urdhrin përmbirimor dhe ti abrogoj të gjitha veprimet juridike.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datën 01.09.2020, kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke arsyetuar se procedura përmbimore në lidhje me trajtimin e dokumenteve të besueshme e sqaron e se faturat janë dokumente të mjaftueshme për përmbirim dhe nuk kërkohet ndonjë dokument tjetër, kreditori me datën 23.03.2020 i ka dërguar vërejtje debitorit duke i dhënë afat shtesë për pagesë të obligimit dhe i njëjti ka injoruar në tërësi vërejtjen dhe shtrohet pyetja logjike si i njëjti nuk ka kërkuar barazim dhe të nxjerrët saldoja pas vërejtjes. Palët nuk kanë qenë të kushtëzuara nga asnjë barazim financiar apo ndonjë kusht tjetër. Kreditori i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas faturave duke e dërguar mallin në kohë dhe duke i jep afat shtesë debitorit

për pagesën e faturave, debitori nuk ka plotësuar asnjë kusht kërkuar me nenin 69 të LPP dhe nuk ka paraqit asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta vërtetoj urdhrin përmbarrimor.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.566/20 të datës 29.01.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara sepse nga shkresat në lëndë shihet qartë se faturat janë të pranuar, të nënshkruara dhe vulosura nga debitori, se kreditori ka plotësuar kushtet sipas faturave, duke dërguar mallin dhe duke i dhënë afat shtesë debitorit për pagesën e detyrimeve dhe duke e njoftuar për mundësinë e dërgimit të lëndës për përmbarrim. Gjykata në mungesë të argumenteve të debitorit për pretendimet e tij, vendimin saj e mbështeti edhe në nenin 245 par.1 dhe 2 të LMD, dhe vlerësoi se pretendimet e debitorit nuk mund të aprovoj ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara dhe në kundërshtim me nenin 69 dhe 71 të LPP.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbarruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarrimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturave origjinale të lëshuara nga kreditori, të cilat fatura në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të njëjtat si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitivin e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbarrim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* çka edhe gjykata shkallës së dytë vlerëson se kreditori ka vepruar në pajtim me këtë nen, nga të cilat fatura të besueshme është caktuar përmbarrimi.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave, të cilat kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarrim, janë plotësuar kushtet

ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat nr.IL ...dt.21.01.2020, IL ...dt.13.06.2019, IL ...dt.23.07.2019, IL ...dt.09.04.2019, IL ...dt.12.05.2020, IL ...dt.21.01.2020, IL ...dt.12.12.2019, IL ...dt.29.08.2019, IL ...dt.18.04.2019 në bazë të së cilave është caktuar përmbarimi, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit sepse të njëjtat janë pranuar secila nga debitori. Sa i përket pretendimit të debitorit se Gjykata Themelore në Mitrovicë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore sepse nuk ka marrë parasysh dhe ka injoruar faktin se kreditori dhe debitori është dashur fillimisht të bëjnë barazimin e kartelave financiare për tu vlerësuar saktë detyrimet e ndërsjella mes tyre, nuk qëndron sepse në shkresat e lëndës askund nuk gjendet ndonjë provë se të njëjtit kanë bërë marrëveshje të tillë, apo kanë kushtëzuar përmbushjen e detyrimit me ndonjë barazim financiar shtu kësaj edhe faktin se të gjitha faturat të cilat kreditori ia ka bashkangjitur propozimit për përmbarim janë të pranuar nga debitori, të nënshkruara dhe vulosura nga ana tij çka do të thotë se i njëjti ka pranuar detyrimin ndaj kreditorit. Po ashtu nga shkresat e lëndës del se kreditori me datën 23.03.2020 ka kërkuar nga debitori përmbushjen e detyrimit duke i dhënë afat shtesë për pagesë deri me datën 31.03.2020 si dhe duke e njoftuar të njëjtin se nëse pagesa nuk i bëhet deri në këtë datë është i detyruar ta inicioj procedurën përmbarimore. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform nenit 69 par.5 të LPP, me çka nuk janë plotësuar edhe kushtet ligjore nga neni 71 të LPP, prandaj vendosi që këto pretendime ti refuzoj si të pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPP lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.276/22, me datë 21.11.2022

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri